

AKTIVITETET KRYESORE TË ADMINISTRATËS DOGANORE SHQIPTARE

PRILL 2024

MEMORANDUM BASHKËPUNIMI MES ADMINISTRATAVE DOGANORE TË SHQIPËRISË DHE ITALISË

Me ftesë të Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave, Genti Gazheli, Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë së Doganave dhe Monopolit të Italisë, Roberto Alesse dhe Komandanti i Përgjithshëm i Guardia di Finanza, Andrea De Gennaro, zhvilluan një vizitë zyrtare në Tiranë. Kjo është vizita e parë e njëkohësishme pranë Doganave Shqiptare e dy drejtuesve të lartë të doganave dhe fiskut italian dhe njëkohësisht vizita e parë jashtë Italisë e Drejtorit të Agjencisë së Doganave dhe Monopolit të Italisë, Roberto Alesse. Gjatë takimit mes drejtuesve të institucioneve financiare u nënshkrua një Memorandum Mirëkuptimi për ngritjen e Komisionit të Përbashkët Doganor Italo-Shqiptar, si një instrument për forcimin e lidhjeve, bashkëpunimin dypalësh dhe lehtësimin e dialogut ndërmjet Administratave Doganore të Italisë dhe Shqipërisë.



PERFORMANCA POZITIVE, TË ARDHURAT NGA DOGANAT NË 3- MUJORIN E PARË TË VITIT 2024, MBI 50 MILIARDË LEKË

Të ardhurat nga Doganat në 3-mujorin e parë të vitit 2024 kanë shënuar rritje të qëndrueshme, duke tejkaluar shifrën **50 miliardë lekë**, ose rreth **500 milionë euro**. Në krahasim me 3-mujorin e parë të vitit 2023, janë realizuar rreth **+2,2 miliardë lekë**, ose rreth **22 milionë euro** më shumë. Kjo ecuri ka ardhur nga miradministrimi dhe rritja e performancës, pavarësisht efekteve negative të kursit të këmbimit, sidomos të TVSH në import, për shkak të nënçmimit të euros dhe dollarit amerikan.



VIZITË NË PORTIN MBM NË PORTO ROMANO

Drejtori i Përgjithshëm i Doganave, Genti Gazheli zhvilloi një vizitë në Portin MBM në Porto Romano, ku volumet e përpunuara për muajin Prill priten të jenë **270 mijë ton** kargo të ngurta dhe **120 mijë ton** hidrokarbure. Rritja me **35%** e kapaciteteve përpunuese në harkun kohor të një viti, reduktimi i kohës së përpunimit të mjeteve lundruese dhe plotësimi i kushteve teknike e ka kthyer këtë port në një pikë orientimi për të gjithë tregun rajonal në vetëm 3 vite aktivitet, duke konkurruar portet në mbarë rajonin.



SEZONI TURISTIK, DREJTORI I DOGANAVE NË PORTIN E DURRËSIT

Drejtori i Përgjithshëm i Doganave, Genti Gazheli zhvilloi një vizitë në Portin e Durrësit, ku me afrimin e sezonit turistik kërkohet një energjizim i të gjithë strukturave pritëse dhe veçanërisht atyre të Doganës. Korrektësia, integriteti dhe bashkëpunimi i ngushtë me strukturat e tjera ligjzbatuese që operojnë në Portin e Durrësit, si porti më i madh në vend, ishte mesazhi kryesor që ai u dha punonjësve të Administratës Doganore. Në këtë Port përgjatë vitit 2023 kanë udhëtuar mbi 827 mijë pasagjerë.



DREJTORI I PËRGJITHSHËM I DOGANAVE GENTI GAZHELI, NË KONFERENCËN E OBD NË BRUKSEL

Me ftesë të Organizatës Botërore të Doganave, Drejtori i Përgjithshëm i Doganave Shqiptare, Genti Gazheli, mori pjesë në Konferencën Rajonale të Drejtorëve të Doganave që u zhvillua pranë selisë së OBD-së në Bruksel. Sekretari i ri i Përgjithshëm i OBD-së, z. Ian Saunders, prezantoi "Draft-Planin e modernizimit të OBD-së" që parashikon forcimin e dimensionit rajonal të OBD-së nëpërmjet zhvillimit të kuadrit për entitetet rajonale dhe formalizimit të qasjes për strukturat rajonale dhe organet e njohura të OBD-së.



PROKOLLI I MONTREALIT, ZHVILLOHET NË TIRANË TAKIMI TEKNIK VJETOR PËR RAJONIN E EUROPËS DHE AZISË

Drejtori i Përgjithshëm i Doganave, Genti Gazheli, mori pjesë sot në takimin teknik vjetor për rajonin e Europës dhe Azisë mbi Zbatimin e Protokollit të Montrealit për mbrojtjen e shtresës së Ozonit, organizuar në Tiranë nga Programi i Mjedisit të Kombeve të Bashkuara (UNEP) dhe Ministria e Turizmit dhe Mjedisit e Shqipërisë. Gjatë fjalës së mbajtur në këtë takim ai u shpreh se, Shqipëria ka në zbatim një bazë të plotë ligjore të Protokollit të Montrealit. Nga ana tjetër Gazheli tha se në sistemin doganor janë krijuar dhe përditësohen rregullisht profilet e riskut për substancat ozonholluese, si dhe për produktet dhe pajisjet që i përmbajnë ato, me qëllim zbatimin e ndalimeve dhe kufizimeve.



DOGANA SHQIPTARE PJESË E PROJEKTIT "ADRIACUSTOMS"

Drejtuës dhe ekspertë të Doganës Shqiptare në datat 16 - 17 Prill 2024 morën pjesë në aktivitetin e prezantimit të Projektit Adriacustoms që synon bashkëpunimin mes administratave doganore të vendeve që lagen nga deti Adriatik në luftën kundër kontrabandës, mallrave të falsifikuara dhe trafikeve të paligjshme. Projekti i financuar dhe mbështur nga OLAF dhe Agjencia Italiane e Doganave dhe Monopolit, përfshin shkëmbimin e eksperiencave më të mira midis Doganës Shqiptare dhe Doganave Italiane, Sllovene, Kroate dhe Malazeze.



QAFË BOTË, FINALIZOHET ME SUKSES PROJEKTI "LËVIZSHMËRIA NË BREGDETIN JONIAN - COMOBILON"

Në 17 prill 2024, në kuadër të bashkëpunimit ndërkufitar Greqi - Shqipëri dhe të finalizimit me sukses të Projektit "Lëvizshmëria në Bregdetin Jonian - COMOBILON", pjesë e Programit Interreg IPA Cross-border Cooperation "Greqi - Shqipëri 2014-2020", u zhvillua një inspektim në Pikën Kufitare Qafë Botë, për rezultatet e implimentimit të këtij projekti. Në këtë vizitë morën pjesë përfaqësues nga Komisioni European, Autoriteti Menaxhues "INTERREG 2021-2027", Sekretariati i Përbashkët i Programit Interreg VI-A IPA III CBC "Greqi-Shqipëri 2021-2027", Agjencia Shtetërore e Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndhmës në Shqipëri (SASPAC), Dogana Shqiptare dhe Policia e Shtetit.



DOGANAT, ULET 17% KOHA E PROCESIMIT TË DEKLARATAVE

Në tremujorin e parë të vitit 2023 u ul me 82 minuta koha e procesimit të deklaratave të mallrave në kanalin e kuq dhe me 17 minuta koha e deklarimit në kanalin e verdhë. Ulja e mëtejshme e kohës së përpunimit të deklaratave në të gjitha kanalet e riskut është edhe një ndër prioritetet e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.

SHËRBIME TË REJA ONLINE

Bazuar në Urdhërin Nr. 31, datë 14.06.2021 "Mbi shtimin e numrit të shërbimeve online në portalin e-Albania", nga muaji prill qytetarët dhe bizneset mund të aplikojnë online nëpërmjet portalit eAlbania edhe për 5 shërbime të reja duke e çuar në 39 numrin e shërbimeve online që ofrohen nga Administrata Doganore Shqiptare:

- Aplikim për Autorizim për Administrim të ambienteve të Magazinimit të Përkohshëm
- Kërkesë për miratim të Autorizimit për përdorimin procedurës së deklarimit të thjeshtëzuar
- Kërkesë për shtesa/ndryshime në Autorizimin e Magazinimit të Përkohshëm
- Kërkesë për transferim Agjenti doganor nga një Agjenci Doganore në një tjetër
- Kërkesë për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve nga një mbajtës tek një tjetër të autorizimit për RLP me përjashtim të pjesshëm

DOGANA DIGJITALE

Drejtorja e Përgjithshme e Doganave i është bashkuar nismës së Qeverisë për të digjitalizuar shërbimet për qytetarët dhe bizneset, nëpërmjet platformës E-Albania. Digjitalizimi i sistemit doganor ka bërë që të krijohen lehtësi për biznesin, shkurtim të kohës procedurale, rritje e transparencës dhe ulje e nivelit të korrupsionit. Vetëm gjatë muajit Prill 2024 nga Administrata Doganore Shqiptare janë miratuar 581 shërbime online.



A E DINI SE ?

- Me më shumë se 2000 deklarata që përpunon në 24 orë, Dogana Shqiptare arkëton për buxhetin mbi 600 milionë lekë, ose rreth 6 milionë euro çdo ditë.
- Mbi 1700 ton karburante dhe më shumë se 25 tonë cigare zhdoganohen çdo 24 orë, si dy produktet që sjellin të ardhurat kryesore për shtetin.
- Rreth 38 aplikime online kryehen çdo ditë nga biznesi, në vijim të digjitalizimit të shërbimeve doganore.
- Sipas studimit të Bankës Botërore, është ulur me 44% koha mesatare e procesimit të deklaratave doganore.
- Sipas Barometrit të Ballkanit, Shqipëria ka procedurat doganore më të shpejta në rajon, si në import, ashtu dhe në eksport.
- Sipas vlerësimit të investitorëve të huaj në Shqipëri, Administrata Doganore ka marrë vlerësimin më të lartë krahasuar me të gjitha institucionet e tjera, 75 nga 100 pikë.

